

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Mr.sci.Muhamet Rexha dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Y. P. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson E. A., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës P.C. B. me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson N. H., avokat nga Prishtina, për shkak të anulimit të vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.954/2014 datë 20.1.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14.11.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.954/2014 datë 20.1.2016.

Aktgjykimi i cituar ndryshohet vetëm përkitazi me kamatën ashtu që detyrohet e paditura që shumën e caktuar sipas pikës III të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë t'ia paguajë me kamatë si për mjetet e deponuara në bankë pa destinim të caktuar mbi 1 (një) vit, nga data 2.8.213 e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.954/2014 datë 20.1.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, C.nr. 2072/2011 datë 18.10.2013, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Y. P., nga Prishtina dhe është anuluar si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës P.C.B., me seli në Prishtinë, Ref.nr..., datë ..., me të cilin paditësit i është ndërprerë kontrata e punës dhe vendimi Reg.nr. ..., datë ..., me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit e ushtruar kundër vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Me pjesën II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësin ta kthejë në punë dhe detyra të punës së udhëheqësit të njësisë për administrimin e kredive me të

gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës. Me pjesën III të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit në emër të dëmit material i cili konsiston në humbjen e fitimit për periudhën prej datës 18.8.2011 e deri më 2.8.2013 t'ia paguajë dhe atë në emër të pagave neto të papaguara shumën prej 28.695 € me kamatë prej 3,5% nga data e ekspertizës më 2.8.2013 e deri në pagesën definitive si dhe në emër të kontributeve pensionale të punëdhënësit të paguajë në Trustin Pensional të Kosovës, në llogarinë e paditësit shumën e mjeteve prej 1.650 €, si dhe në emër të tatimit në paga t'ia paguajë Buxhetit të Kosovës shumën prej 2.190 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Me pjesën IV të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1.283 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar ose ato të prishen dhe çështja t'ia kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi nga data 1.11.2001 ka krijuar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, në pozitën udhëheqës i Njësisë së Administrimit të Kredive. E paditura me njoftimin nr. ..., datë ..., ka njoftuar paditësin se për shkak të nevojës së shqyrtimit të rastit lidhur me vërejtjet që i ka pranuar e paditura nga Raporti i BQK-së, është suspenduar me pagesë duke filluar nga data 25.7.2011 e deri në njoftimin e radhës. Me vendimin Ref.nr..., datë ..., menaxheri i të paditurës, paditësit ia ndërprente kontratën e punës me efekt nga data 18.8.2011, me arsyetim se paditësi ka bërë shkelje të rëndë të procedurave të Bankës. Me vendimin nr. ..., datë ..., menaxheri i bankës ka refuzuar ankesën e paditësit, paraqitur kundër vendimit për ndërprerjen e kontratës së punës Ref.nr..., datë ..., Nga vendimi nr. ..., datë ..., del se e paditura është dënuar me gjobë në shumë prej 30.000 €, për arsye se nuk ka raportuar

saktë klasifikimin e kredive në regjistrin e kredive të Kosovës, ashtu që ka raportuar me klasifikim më të favorshëm krahasuar me klasifikimin e regjistruar në librat e bankës.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur se vendimet e të paditurës janë marrë në mënyrë të kundërligjshme dhe pa bazë ligjore duke mos vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, dhe duke e vlerësuar se vendimi mbi ndërprerjen e kontratës së punës është në kundërshtim me nenin 70 të Ligjit të Punës, pastaj ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës ka vlerësuar se aktgjykimi i ankimuar është i drejt dhe i ligjshëm, ngase në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsyet konkrete për faktet vendimtare, si dhe janë dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për një vendosje të tillë, bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen çështjes juridike të paditësit, pastaj ka refuzuar ankesën e të paditurës si të pabazuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndërsa lidhur me caktimin e kamatës kjo Gjykatë vlerëson se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, andaj në këtë pjesë u deshtë që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen.

Pretendimi i theksuar në revizion se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore nga neni 182 par. 1 dhe par. 2 pika (n) të LPK, siç ceket, se arsyetimi i aktgjykimit është në tërësi kontradiktor me vetveten dhe gjykata ka tejkalluar autorizimet ligjore të dhëna me Ligjin e Punës, ngase me asnjë nen të ligjit të cekur nuk parashihet mundësia që gjykata të lëshohet në vërtetimin e gjendjes faktike por vetëm në verifikimin e respektimit të procedurës disiplinore, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuara. Kjo ngase, në revizion përveç që është cituar dispozita ligjore me asnjë pretendim konkret nuk është cekur se në cilën pjesë të aktgjykimit arsyetimi është kontradiktor me dispozitivin, ndërsa faktin e cekur se gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë shkelje të procedurës disiplinore, kjo Gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të

drejt kanë vlerësuar se të paditurës i është shqiptuar gjoba për shkak të mos raportimit të rregullt të kredive nga ana e të paditurës dhe jo si rezultat i procedurave të hartuara të raportimit të kredive. Gjykatat e instancës më të ulët me asnjë provë nuk kanë mundur të vërtetojnë se paditësi ka bërë shkeljen për të cilën ka pretenduar e paditura në kuptim të nenit 9.1.2 dhe 5.5.1 të Politikave të Personelit, andaj, me të drejtë është vlerësuar se me rastin e marrjes së vendimit për shkëputjen e kontratës së punës dhe vendimit për refuzimin e ankesës, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejt, e cila shkelje është vlerësuar konform nenit 70 të Ligjit të Punës.

Gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë vlerësuar se me rastin e marrjes së aktvendimit për ndërprerjen e kontratës së punës, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejt, ngase dëshmitarja E. B., zëvendës drejtoresh e përgjithshme te e paditura, para gjykatës ka deklaruar se paditësi ka hartuar procedurën për kërkim dhe dërgim në regjistrin e kredive të Kosovës, ndërsa të dhënat nga regjistri i Njësisë së Riskut dhe MIS-it dërgohen në zyrën përkatëse në BQK, dhe procedura për dërgimin e të dhënave në nivel të paditurës është nënshkruar nga dëshmitarja e cekur.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar është në harmoni me dispozitivin, i njëjti përmban të gjitha arsyet për faktet vendimtare për gjykim të drejtë e të bazuar me ligj.

Pretendimin e cekur se gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë marrë për bazë faktin se paditësi kishte krijuar punën në një kompani tjetër (Afganistan) me çka e ka zvogëluar dëmin eventual të shkaktuar nga ndërprerja e marrëdhënies së punës, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi, por e njëjta nuk ndikoi që kjo Gjykatë të vendos ndryshe, ngase kjo Gjykatë revizionin e shqyrton konform nenit 215 të LPK dhe shkresave të lëndës, ndërsa në këtë fazë të procedurës nuk mund të paraqiten prova të reja, të cilat kanë mund të përdoren në ndonjë fazë tjetër të procedurës.

Pretendimet se gjykata duke mos ia dhënë detyrat në mënyrën e duhur ekspertes financiare ka bërë aplikim të gabuar të dispozitave për kompensimin e dëmit material, Gjykata Supreme e vlerësoi si të pabazuar, ngase i autorizuari i të paditurës në shqyrtimin kryesor datë 18.10.2013 ka deklaruar se nuk e konteston raportin financiar dhe nuk ka kërkuar caktimin e

ndonjë ekspertize tjetër dhe asnjëherë nuk ka potencuar faktet se paditësi është duke punuar dikund tjetër.

Pretendimet e të paditurës të cekura në revizion se në mënyrë të gabuar është zbatuar neni 70 i Ligjit të Punës, Gjykata Supreme e vlerësoi si të pabazuar, ngase neni i cekur në mënyrë të çart përcakton kushtet ligjore kur punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit, ndërsa në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet e parapara sipas këtij neni, andaj gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejt kanë zbatuar dispozitën e cekur kur kanë vendosur si në dispozitivin e aktgjyimit të kundërshtuar.

Gjykata Supreme e Kosovës , pretendimet e cekura lidhur me zbatimin e gabuar të nenit 80 të Ligjit të Punës , i vlerësoi si të pabazuara , ngase të punësuarit me rastin e largimit të kundërligjshëm nga puna duhet t'i paguhet edhe kompensimi i paraparë sipas nenit të cekur , siç me të drejt kanë vlerësuar edhe gjykatat e instancës më të ulët.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke shqyrtuar aktgjykimin e kundërshtuar, vërejtji se lidhur me caktimin e kamatës gjykatat e instancës më të ulët të drejtën materiale e kanë zbatuar në mënyrë të gabuar, andaj, të njëjtin e ndryshoi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 222 dhe 224 par. 2 të LPK, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.298/2016, më 14.11.2016

Kryetare e kolegjit,

Emine Kaçiku